

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ- Departamenti i Pergjithshem- Divizioni Civil, me gjyqtarin Enes Mehmeti, me sekretaren juridik Minire Krasniqi, në çështjen juridike të paditësit [REDAKTUAR] nga fsh. [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj dhe [REDAKTUAR] nga fsh. [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj, të cilët i përfaqëson av. [REDAKTUAR], kundër të paditurit [REDAKTUAR] nga fsh. [REDAKTUAR] tani me adresë të panjohur, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm av. [REDAKTUAR] nga Ferizaj, në seancën e mbajtur me datë 07.03.2018, merr këtë:

AKTGJYKIM

I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësve [REDAKTUAR] nga fsh. [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj dhe [REDAKTUAR] nga fsh. [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj, me të cilën ka kërkuar që të **VËRTETOHET** se janë bashkëpronarë të njësisë kadastrale P-72217082-00609-0, në vendin e quajtur "Kodra", me sipër. 15594m² në zonën kadastrale në [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj, këtë në afat prej 15 ditësh pas pranimit të kopjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Arsyetimi

Paditësit me padi, në seancat e mbajtur si dhe në fjalën e tij përfundimtare përmes të autorizuarit të tyre kanë deklaruar se nga provat e administruara gjatë shqyrtimit të çështjes, nga dëshmit e dëshmitarëve [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe paditësit të dytë [REDAKTUAR] i dëgjuar në cilësin e palës është vërtetuar fakti se paditësit me ish pronarin e paluajtshmërisë [REDAKTUAR] kanë lidhur marrëveshje gojore mbi shitblerjen e paluajtshmërisë P-72217082-00609-0, të cilën edhe sotë e kanë në posedim të qetë e të penguar nga askush. Të paditurit pasi që kanë arritur marrëveshje për shitblerjen e paluajtshmërisë me të paditurinë, marrëveshje kjo në mesë pronarit legjitim dhe tani pronarëve faktik është zbatuar në tërësi si dhe janë përmbarur të gjitha elementet kontraktuese, ashtu që shitësi ka pranuar çmimin e shitblerjes dhe i'a ka dorëzuar në shfrytëzim, posedim të qetë të papenguar nga askush paluajtshmerinë blerësve, lidhur me pranimin e çmimit nga ana e të paditurit kjo është dëshmuar edhe nga dëshmia e dëshmitarëve.

Andaj në bazë të dëshmive të dëshmitarëve, deklarimet e paditësit të dytë, në bazë të posedimit me mirëbesim dhe të qetë e të papenguar të paluajtshmërisë në zonën kadastrale [REDAKTUAR] që nga viti 1970 e ka fituar të drejtën e pronësisë konform nenit 20 të Ligjit mbi

Mardhënjet pronësore juridike si dhe 40 par.1 të Ligjit për pronësi dhe të drejtat tjera sendore të republikës së Kosovës.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit, në përgjigje në padi, secat e mbajtura dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se paditësit kanë potencuar se paditësit nga i padituri kanë blerë ngastrën kadastrale P-72217082-00609-0 si dhe kanë potencuar se shuma e kontraktuar i'a kanë paguar në tërësi sipas marrëveshjes mbi shitblerjen në vitin 1970, dhe si provë thirren në marrëveshjen e shitblerjes dhe nenin 28 par.4 të LMPJB. Duke shtuar se si përfaqësues i përkohshëm me anë të përgjigjes në padi e kam kontestuar kërkesëpadinë e paditësve pasi që nuk kanë vërtetuar thënjet në padis kinse e kanë fituar këtë paluajtshmëri me anë të marrëveshjes mbi shitblerjen e saj. Dëshmitarët e dëgjuar ku me anë të pyetjeve jam munduar të zbardhi të vërtetën nëpërmjet dëgjimit të tyre. Dëshmitarët [REDACTED] dhe [REDACTED] që të dy kanë deklaruar se baballarët e paditësve qysh në vitin 1970 i kanë blerë paluajtshmërit nga i padituri si dhe kanë të njohur se paditësit në tërësi kanë paguar këtë paluajtshmëri. I padituri i dytë i dëgjuar në cilës të palës ka deklaruar se babai i tij [REDACTED] nga i padituri dhe se të njëjtën paluajtshmëri e kanë ndarë me nga ½ me [REDACTED] pasi që e kanë pasur në megjë si dhe i njëjti ka spjeguar burimin e parave për të blerë këtë paluajtshmëri.

Si përfaqësues i përkohshëm ka kërkuar nga gjykata që pas shtjellimit të provave, të aplikoj neni 8 të LPK-së dhe pas çmuarjes së lirë të provave lidhur me këtë kontest në bazë të bindjes së lirë të gjykatës, ka propozuar të bie aktgjykim meritor për palët në këtë procedurës.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes së fakteve të çështjes, për aq sa palët ndërgjygjëse përmbushin detyrimin e tyre për t'i parashtruar ato, në kuptim të nenit 7.1 të LPK-së, Gjykata ka administruar provat: Dëshmit e dëshmitarëve dhe mendimi i ekspertit të gjeodezisë [REDACTED].

Gjykata pasi beri shqyrtimin dhe analizen e provave të çështjes, këtu në kuptim të nenit 8 të LPK-së, kur ka bere vleresimin e tyre vec e vec dhe si te nderlidhrua mes veti, si teresi, a mbi bazen e bindjes se lire e krijuar mbi bazen e gjendjes se fakteve dhe provave te ceshtjes, ka vleresuar se duhej vendosur si ne dispozitiv.

Nga deklarimi i palëve ndërgjygjëse, dëshmit e dëshmitarëve dhe provave të administruara në këtë procedurë Gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

- Se paraardhësit e paditësve këtë paluajtshmëri e kanë blerë nga i padituri në vitin 1970 në bazë të marrveshjes gojore, e cila marrveshje nuk është formalizuar asnjëherë nga asnjëra palë dhe se të njejtit për këtë paluajtshmëri kanë paguar në tërësi çmimin e kontraktuar të shitblerjes.

- Nga deklarata e dëshmitarëve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] u vërtetuar se dëshmitarët me paditësin janë në marrëdhënje të ngushta familjare axhë dhe nip si dhe vëllezër.

- Dëshmitari [REDAKTUAR] sqaroi rrethanën vëllau i tij respektivisht babai i [REDAKTUAR] në vitin 1970 ka blerë pronën kontestuese dhe se të njejtit me sa i kujtohet kjo pronë ka pas një sipërfaqe prej 1 hektarë më shumë apo më pak këtë nuk e di dhe se të njejtën e kishte blerë nga një serbë i cili ka jetuar në fshatin Bibaj dhe se ka qenë prezentë në odën e familjes së tij kur [REDAKTUAR] e ka blerë pronën nga një serb dhe prezentë aty ka qenë edhe një serb tjetër quhet [REDAKTUAR] i cili e ka njohur gjuhen serbe dhe ka shërbyer si përkthyes. Ka sqaruar se se prona gjendet në rrugën Ferizaj- Sojevë dhe se serbi nga i cili e ka blerë [REDAKTUAR] paluajtshmërinë i njejtë edhe një kohë ka jetuar në fshatin [REDAKTUAR] dhe se të njejtin e kanë parë shpesh për shkak se ka punuar si furnizues i pompave të benzinës. Këtë pronë [REDAKTUAR] me djemt e tij e kanë punuar pasi që i njejtë ka qenë i ndarë nga vëllezërit dhe asnjëherë nga askush nuk ka pasur pengesa për shfrytëzimin e kësaj toke as nga i padituri [REDAKTUAR] as nga personat tjerë.

- Dëshmitari [REDAKTUAR] ka sqaruar rrethanën se babai i tij në vitin 1970 e ka blerë këtë pronë nga [REDAKTUAR] shofer i ish "Jugopetrollit" i cili ka jetuar në fund të rrugës së [REDAKTUAR] dhe me sa më kujtohet ai ka qenë ose nga fshati [REDAKTUAR] ose nga fshati [REDAKTUAR] ka shtuar se pazarin e kanë bërë në fshatin [REDAKTUAR] në Dugajën e fshatit ku prezentë ka qenë edhe një serb tjetër [REDAKTUAR] putari-mirëmbajtësi i rrugëve.

- Nga deklarata e [REDAKTUAR] të dhënë në cilësinë e palës i njejtë ka deklaruar se këtë pronë e ka blerë babai i tij [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] e kemi pasur fqinjë. Babai im për të blerë këtë pronë nga [REDAKTUAR] i ka shitur dy lopë dhe ka hyrë në kredi për shkak se në atë kohë punonte në shkup si ndërtimtar, pasi që e kemi blerë këtë pronë nga [REDAKTUAR] është paraqitur [REDAKTUAR] axha i paditësit [REDAKTUAR] dhe na ka njoftuar se këtë pronë duhet të ndajm për gjysmë për shkak se ata si mexhanik kanë të drejtë edhe ata për ta blerë dhe se babai im është pajtuar me këtë dhe ne kemi ndarë pastaj në dy pjesë pronën e [REDAKTUAR], një pjesë e ka marr familja [REDAKTUAR] ndërsa pjesën tjetër ne. Ka shtuar faktin se shumë prej 7500 banka të atëhershme ne i'a kemi paguar të paditurit në shtëpinë tonë ndërsa [REDAKTUAR] pjesën e tyre i'a kanë paguar në dugajën e tyre. Ka shtuar se [REDAKTUAR] ka jetuar edhe pas kësaj në Ferizaj dhe se të njejtin e kanë takuar disa herë dhe e kanë lutur që të ua përkthej pronën por i njejtë është

arsyetuar se nuk po mundet për shkak se shteti nuk po e lejon dhe se i kujtohet fakti se në tri raste atij i ka dhënë 100 DM për të në banjë në emër të tatimit që ka paguar për pronën kontestuese e të cilat i'a ka kërkuar [REDAKTUAR]

Gjykata shqyrtoi deklaratën e paditësit të dytë [REDAKTUAR] të dhënë në cilësinë e palës dhe atë të dëshmitarëve tjerë [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] dhe të njejtave nuk u'a fali besimin, pasi që të njejtat ishin objektive dhe jo reale, të njejtat në vete përmbanin zbrazëti dhe magësi rreth rrethanave lidhur me shitblerjen e pronës, të cilat deklarata nuk janë vërtetuar me asnjë provë materiale.

-Gjykata me anën e ekspertit të gjeodezisë ka bërë identifikimin dhe inqizimin e pronës ku ka gjetur se të dhënat kadastrale dhe ato në terren përputhen në tërësi me njëra tjetrën dhe si pronar juridik i saj është [REDAKTUAR].

Andaj, gjykata ka ardhur në përfundim se pretendimet e paditësve në raport ndaj të paditurit janë të pa bazuar, për faktin se të njejtat nuk kanë arritur të vërtetojnë faktin e shitblerjes së kësaj prone si dhe nuk kanë arritur me asnjë provë, fakti apo rrethan të vërtetojnë faktin e posedimit të paluajtshmërisë me mirëbesim për më shumë se 20 vite, andaj mbi këtë bazë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi kjo për faktin se duke u bazuar në nenin 319 lidhur me nenin 322 të LPK-së barra e provës i bije paditësve dhe me qenëse të njejtat me asnjë provë bindëse nuk i kanë vërtetuar pretendimet e tyre gjykata ka refuzuar kërkesë padinë e paditësve si të pa bazuar.

Mbi bazën e parashtrimeve të mësipërme është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

C.nr.316/13, me datën 07.03.2018

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA
VENDIMI ËSHTË I PLOTËFJOISHËM
ODLUKA JE PRAVNO NA ZNA
GJYKATA THEMELORE KOSOVOVNI SUD
FERIZAJ II UROSEVAC

Më
Dana 03.05.2018

[REDAKTUAR]

Gjyqtari,
Enes Mehmeti

KËSHILLË JURIDIKE: Kunder këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankese në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të tij, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.